



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr.263, dt. 13.12.2016

Në mbështetje të ligjit nr.9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore", i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 13.12.2016, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

- Miratimin e projektit: "Ndryshim i modelit të parrmakëve – Rikonstruksim i trotuarit, ndriçimit dhe riveshje me shtresa asfaltike të rruga "Antipatrea", segmenti Ura e Varur – Ura e Goricës, Berat me vëretjtjet si më poshtë:
  - Kangjellat e propozuara nga Ura e Varur e deri te Ura e Goricës duhet të imitojnë tipin, modulën e kangjellës dhe ngjyrën e përdorur në shëtitoren Osumi.
  - Ndriçimi i lartë të kalojë nga trotuari në krahun e lumit ndërsa trotuari nga ana e lagjes Mangalem të ketë ndriçim mural nga xhamia e " Beqarëve " e deri te banesa e fundit e lagjes Mangalem. Nga banesa e fundit e deri përballë urës së Goricës të vendosen shtylla dekorative 3.5 m me llambë LED. Të respektohen detajet në materialin e paraqitur nga DRKK - Berat.
  - Trotuari të shtrohet me pllakat ekzistuese me gurë të vjetër ranor dhe shtrimi të bëhet me llaç nga xhamia e Beqarëve e në vijimësi. Pas përdorimit të gurëve të vjetër, pllakat e reja të respektojnë përmasat, modulën dhe tipin e vjetër të shtrimit.
  - Linjat elektrike ajrore në rreshtin e parë të dyqaneve të kalojnë nëntokë dhe të parashikohen dy linja paralele tub pvc Ø 125 për disiplinimin e rrjetit egzistues.
  - Të gjitha linjat e kanalizimeve të dëmtuara, tubacionet KUL, KUZ apo çdo rrjet i amortizuar të zëvendësohet.
- Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
- Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR  
MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI